



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 nëntor 2021
Nr. ref.:RK 1883/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI139/20

Parashtrues

Ilir Millaku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit
Ac. nr. 901/19, të 20 majit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ilir Millaku (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës) nga Prizreni, të cilin e përfaqëson Avni Thaçi, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin Ac. nr. 901/19, të 20 majit 2020, si dhe Aktvendimin PPP. nr. 392/19 të Gjykatës Themelore në Prizren të 25 qershorit 2019.
3. Aktvendimi Ac. nr. 901/19 i Gjykatës së Apelit, i 20 majit 2020, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 qershor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat parashtruesi pretendon të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 12 tetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi si Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 15 tetor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
9. Më 15 tetor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren që të dorëzojë një kopje të fletëkthesës që dëshmon kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Aktvendimi Ac. nr. 901/19, i 20 majit 2019.
10. Më 27 tetor 2020, Gjykata Themelore në Prizren dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e dorëzimit të Aktvendimit Ac. nr. 901/19 të Gjykatës së Apelit, të 20 majit 2019, te parashtruesi i kërkesës, me datën e dorëzimit -17 qershor 2020.
11. Më 21 tetor 2021, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtuesi rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 25 qershor 2019, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: KEK) paraqiti kundër parashtresit të kërkesës një propozim për përmbarim për shkak të borxheve të papaguara për energjinë elektrike të konsumuar për periudhën prej 26 dhjetorit 2012 deri më 20 mars 2013. Në të njëjtën datë, përmbaruesi privat E.H. e lejoi përmbarimin përmes Urdhrit P. nr. 456/2019.
13. Më 3 korrik 2019, parashtresë i kërkesës paraqiti kundërshtimin ndaj Urdhrit përmbarimor (P. nr. 456/2019) në Gjykatën Themelore në Gjakovë, duke deklaruar se borxhi i kontestuar është parashkruar.
14. Më 25 shtator 2019, Gjykata Themelore në Prizren përmes Aktvendimit [PPP. nr. 392/2019] refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e debitorit përmbarimor, duke arsyetuar se parashtresë i kërkesës e ka pranuar borxhin ndaj KEK-ut duke lidhur një kontratë për ripagimin e borxhit (nr. 58119) të 23 gushtit 2017 me KEK-un.
15. Më 9 dhjetor 2019, parashtresë i kërkesës paraqiti në Gjykatën e Apelit ankesën ndaj Aktvendimit [PPP. nr. 392/2019] të Gjykatës Themelore në Prizren për shkak të *“shkelje[s] thelbësore të dispozitave të procedurës civile, konstatim[it] të gabuar dhe jo të plotë të fakteve, si dhe për shkak të shkeljes së të drejtës materiale”*.
16. Më 20 maj 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 901/19], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtresit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke arsyetuar se *“Pretendimi ankimor i debitorit ka të bëjë me faktin se të njëjtit në këtë rast i mungon legjitimiteti pasiv, pasi që ekziston një kontratë për pagesën e borxhit nr. 58119 e datës 23 gusht 2017, si dhe deklarimi për dakordimin e borxhit, të cilat janë lidhur ndërmjet kreditorit dhe një personi tjetër - Fisnik Millaku, andaj konsideron se ky borxh nuk mund t'i faturohet. Gjykata e Apelit, lidhur me këtë pretendim vlerëson se në rastin konkret përmbarimi është lejuar në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist për pagesën e shërbimeve komunale - për konsumin e energjisë elektrike DPZ - 9037630, nga i cili dokument dëshmohet se në cilësinë e konsumatorit është pikërisht debitori Ilir Millaku, andaj provat e lartpërmendura nga ana e debitorit, siç janë kontrata për pagesën e borxhit, nr. 58119, e datës 23 gusht 2017 si dhe deklarata për dakordimin e borxhit nuk janë relevante në këtë çështje përmbarimore.*
Pretendimi tjetër ankimor se borxhi është parashkruar pasi kemi të bëjmë me borxh të viteve 2012 dhe 2013, i cili borxh në bazë të nenit 360, paragrafi 1. 1 të LMD-së parashkruhet pasi të ketë kaluar 1 vit, Gjykata e Apelit e vlerëson se është pretendim i pabazuar dhe i paqëndrueshëm pasi që me dispozitën e nenit 368, paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, dhënia e sigurimit”. Në kuptim të kësaj dispozite Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që nga shkresat e lëndës respektivisht nga ekstrakti i verifikuar ngalibrat afarist për pagesën e shërbimeve komunale-për konsumin e energjisë elektrike DPZ -

9037630, është vërtetuar se debitori kohë pas kohe ka realizuar pagesa, të cilat pagesa kanë rezultuar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht edhe me ndërprerjen e parashkrimit. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoi se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe se ankesa e parashtruar nga kreditori duhet të hidhet si e pasafatshme ndërsa ankesa e parashtruar nga debitori të refuzohet si e pathemeltë”.

17. Më 23 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës, ndaj aktvendimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, i paraqiti propozimin Prokurorit të Shtetit për iniciimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme.
18. Më 6 gusht 2020, Prokurori i Shtetit me Njoftimin KMLC nr. 91/2020, e njoftoi parashtruesin e kërkesës se “*propozimi nuk u pranua, sepse në këtë çështje nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë*”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit si dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, “*po të shikohet në këtë kontratë dhe në këtë deklaratë në të cilat thirret edhe Gjykata Themelore, vërehet se figuron emri dhe nënshkrimi i z. Fisnik Millaku si konsumator, e gjithashtu se në cilat shkresa të lëndës e ka gjetur shumën prej 1,440.02 €, kjo gjykatë nuk jep shpjegim, duke shkelur kështu të drejtën e debitorit për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, respektivisht duke shkelur nenin 31 të Kushtetutës së R. Kosovës*”.
21. Parashtruesi i kërkesës ka shtuar se, “*Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj Ac. nr. 901/20 të datës 20.05.2020, ka dështuar të ofrojë një arsyetim që i përmbush standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse vendimi i kësaj gjykate përmban një arsyetim të përgjithshëm dhe i cili nuk është i bazuar në rrethanat e veçanta dhe të gjendjes faktike të rastit konkret dhe për më tepër nuk sqaron se pse në këtë rast është zbatuar neni 368 par. 1 i LMD-së dhe jo neni 360 par. 2 i LMD-së, pra e anashkalon paragrafin 2 të nenit 360 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore i cili parasheh parashkrimin e kërkesave për pagesë pas kalimit të afatit prej një viti (pasi që pagesa e parë është bërë pas më shumë se 3 vitesh, tek në vitin 2018) dhe thirret gabimisht në nenin 368 par. 1 të LMD-së që parasheh ndërprerjen e parashkrimit kur debitori e pranon borxhin, me çka debitorit i shkelen të drejtat dhe liritë themelore që parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës, respektivisht neni 31 në lidhje me nenin 6 par. 1 të KEDNJ-së*”.
22. Sa i përket refuzimit të kërkesës së tij për mbrojtjen e ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës pretendon se, “*shihet se në rastin e ngjashëm Prokurori i Shtetit e kishte aprovuar kërkesën e debitorit dhe kishte paraqitur Kërkesë për mbrojtje*

të ligjshmërisë, ndërsa Gjykata Supreme me Aktvendimin e lartpërmendur e kishte aprovuar kërkesën e tillë, në rastin tonë Prokurori i Shtetit nuk e mori fare parasysh këtë dhe me 'Njoftimin', KMLC nr. 91/2020 të datës 06.08.2020, e refuzon kërkesën duke çuar kështu në shkelje nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe shkelje të parimit të sigurisë juridike, e me këtë edhe të së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së". Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës bashkëngjiti Aktvendimin e Gjykatës Supreme CML. nr. 39/2018, të 25.06.2018.

23. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë që kërkesa e tij të deklarohet e pranueshme, që Gjykata të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që të detyrojë Prokurorin e Shtetit të iniciojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës për anulimin e aktvendimeve të mësipërme si të paligjshme dhe që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës të vendosë për meritat ose të deklarojë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PPP. nr. 392/2019, të datës 25.09.2019, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 901/20, të datës 20.05.2020, dhe Njoftimin e Prokurorit të Shtetit, KMLC. nr. 91/2020, të datës 06.08.2020, si dhe që çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

1. *Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*

2. *Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.*

[...]

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*

2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a*

shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatare, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që

çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

**Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve
Ligji i 10 majit 2012**

[...]

NËNKREU 2

AFATI I PARASHKRIMIT

[...]

Neni 360

Afati njëvjeçar i parashkrimit

1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti:

1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;

1.2. kërkesat e radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit;

1.3. kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separateve postale, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra;

1.4. kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës për të cilën është porositur botimi;

1.5. kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mail-it, shërbimet për mirëmbajtjen e "faqes elektronike", dhe shërbimet e lidhura me qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra;

1.6. kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve për shërbimet dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtra.

2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.

3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë.

[...]

NËNKREU 4

NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT

Neni 368

Pranimi i borxhit

1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.

2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kushteve të pranueshmërisë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesat individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

27. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës është palë e autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, respektivisht Aktvendimin [Ac. nr. 901/19] të Gjykatës së Apelit të 20 majit 2020, pasi që ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtuesi gjithashtu theksoi të drejtat dhe liritë themelore që pretendohen të jenë shkelur, në përputhje me kushtet e nenit 48 të Ligjit dhe paraqiti kërkesën e tij në përputhje me afatet e specifikuara në nenin 49 të Ligjit.
28. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
29. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që t’i shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
30. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Letonisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
31. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28 si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 39).

32. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuarra janë shkelur neni 3, neni 31, neni 32 dhe neni 54 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së.
33. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me: (i) vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, përkatësisht me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale, sepse është zbatuar “*neni 368 par. 1 i LMD-së, dhe jo neni 360 par. 2 i LMD-s*”; (ii) pretendimet për shkelje të parimit të barazisë para ligjit dhe parimit të sigurisë juridike; dhe (iii) me pretendimin për shkelje të tjera të të drejtave kushtetuese.
34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i përsërit të njëjtat argumente që ai i kishte paraqitur në procedurat pranë Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit dhe se gjykatat e rregullta janë marrë me këtë çështje, prandaj, Gjykata, në paragrafët vijues, do të shtjellojë më tej procedurat para gjykatave të rregullta.

Lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së

35. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka cekur shprehimisht shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, duke i lidhur shkeljet e pretenduara me vërtetimin e fakteve, respektivisht me mos marrjen parasysh të parashkrimit dhe kështu edhe me zbatimin e gabuar të ligjit, pa shtjelluar më tej në baza kushtetuese se si dhe pse janë shkelur këto nene konkrete të Kushtetutës.
36. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ndërtoi rastin e tij mbi baza ligjshmërie, respektivisht mbi procesin e vërtetimit të fakteve. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih rastin KI56/17, parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
37. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe gjithashtu në përputhje me praktikën e saj të konsoliduar, Gjykata thekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte përse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar dhe jo në ndonjë mënyrë tjetër (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, nr. 30544/96 të 21 janarit 1999, par. 28, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
38. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një procedurë provat janë paraqitur në mënyrë të duhur dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi i kërkesës të

ketë pasur gjykim të drejtë (shih, mes shumë burimeve të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

39. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktvendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit është i qartë, dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
40. Në rrethanat e rastit konkret, në mënyrë që edhe më konkretisht të elaborohen parimet e përgjithshme të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit e refuzuan kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, gjatë interpretimit të dispozitave të LMD-së, ashtu siç kanë vlerësuar se është mënyra më e drejtë për interpretimin e tyre, theksuan se ankesa e parashtruesit të kërkesës është e pabazuar.
41. Gjykata Themelore, në aktgjykimin e saj, arsyetoi se me lidhjen e Kontratës nr. 58119 të datës 23.08.2017 lidhur me pagesën e borxhit që figuron deri në vitin 2008, parashtruesi i kërkesës ka pranuar ekzistencën e borxhit, me këtë kontratë ishte paraparë se duke mos paguar tri këste radhazi do të konsiderohet se pala debitore nuk ka paguar këstet përkatëse (shumën përkatëse) sipas kontratës së përmendur për riprogramimin e pagesave pasi pala debitore nuk ka bërë pagesën e kësteve përkatëse kontrata anulohet si dhe pjesa e papaguar e borxhit, nëse ka, fshihet nga borxhi i papaguar, i cili kthehet duke përfshirë të gjitha gjrobat.
42. Lidhur me legjitimitetin pasiv të parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj ka dhënë arsyetimin vijues: *“Gjykata e Apelit, lidhur me këtë pretendim vlerëson se në rastin konkret përmbarimi është lejuar në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist për pagesën e shërbimeve komunale - për konsumin e energjisë elektrike DPZ - 9037630, nga i cili dokument dëshmohet se në cilësinë e konsumatorit është pikërisht debitori Ilir Millaku, andaj provat e lartpërmendura nga ana e debitorit, siç janë kontrata për pagesën e borxhit, nr. 58119, e datës 23 gusht 2017 si dhe deklarata për dakordimin e borxhit nuk janë relevante në këtë çështje përmbarimore”*.
43. Lidhur me parashkrimin e borxhit të parashtruesit të kërkesës ndaj KEK-ut, Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj ka dhënë arsyetimin vijues: *“[pretendimin] se borxhi është parashkruar pasi kemi të bëjmë me borxh të viteve 2012 dhe 2013, i cili borxh në bazë të nenit 360, paragrafi 1. 1 të LMD-së parashkruhet pasi të ketë kaluar 1 vit, Gjykata e Apelit e vlerëson se është pretendim të pabazuar dhe i paqëndrueshëm pasi që me dispozitën e nenit 368, paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, dhënia e sigurimit”. Në kuptim të kësaj dispozite Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që nga shkresat e lëndës respektivisht nga ekstrakti i verifikuar nga librat afarist për pagesën e shërbimeve komunale-për konsumin e energjisë elektrike DPZ - 9037630, është vërtetuar se debitori kohë pas kohe ka realizuar pagesa, të cilat pagesa kanë*

rezultuar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht edhe me ndërprerjen e parashkrimit”.

44. Në lidhje me këtë, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat pranë gjykatave të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, ose që të drejtat dhe liritë e tij themelore të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih rastin KI63/16, parashtruesi *Astrit Pira*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44, dhe shih gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtruesit *Arben Gjukaj*, *Hysni Hoxha*, *Driton Pruthi*, *Milazim Lushtaku*, *Esat Tahiri*, *Azem Duraku* dhe *Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
45. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, si dhe arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk argumenton në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta kanë aplikuar ligjin në mënyrë të gabuar dhe kanë vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike në lidhje me parashkrimin e borxhit. Gjykata i cilëson këto pretendime si pretendime “*të shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “*ligjshmërisë*” dhe nuk janë argumentuar në nivel të “*kushtetutshmërisë*”. Rrjedhimisht, ato janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
46. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e saj gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si pasojë i interpretimit të gabuar të dispozitave të LMD-së, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese si pretendime të “*shkallës së katërt*”.
47. Gjykata, në fund, rikujton se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendime të argumentueshme për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
48. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, përkatësisht të parimit të barazisë para ligjit dhe parimit të sigurisë juridike

49. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me trajtimin e pabarabartë që ai e vë në lidhje me shkeljen e nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, Gjykata vëren se neni 3 në fjalë bie nën Kapitullin I [Dispozitat Themelore] të Kushtetutës, që nuk mund të vlerësohet brenda fushëveprimit të kësaj ankese kushtetuese. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konkludon se ai nuk do të merret me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës.
50. Megjithatë, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi i kërkesës vë në dukje edhe pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës lidhur me trajtimin e pabarabartë, të cilat ai i ndërlidh me njoftimin e Prokurorit të Shtetit, përkatësisht faktit se *“në një rast të ngjashëm Prokurori i Shtetit e kishte aprovuar kërkesën e debitorit dhe kishte paraqitur Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ndërsa Gjykata Supreme, me Aktvendimin e lartpërmendur e kishte aprovuar kërkesën e tillë, në rastin tonë Prokurori i Shtetit nuk e mori fare parasysh këtë”*. Duke i ndërlidhur pretendimet me çështjen konkrete, si dhe me garancitë dhe parimet e barazisë para ligjit dhe parimin e sigurisë juridike, përkatësisht me trajtimin e pabarabartë, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës të gjitha pretendimet e lidhura me pohimet e tij, i sjellë në kontekstin e nenit 24 të Kushtetutës.
51. Duke iu referuar parimeve të përcaktuara të GJEDNJ-së, Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja përdor tri kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje, si në vijim: (i) nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë *“të thella dhe afatgjata”*; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së: *Beian kundër Rumanisë* (nr. 1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37-39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafët 116-135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 52; dhe *HyatiÇelebidhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 52; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës: KI42/17, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 39). Gjykata vëren se asnjë nga kushtet e mësipërme nuk është i pranishëm në rastin e parashtruesit të kërkesës.
52. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rithekson se nuk është funksioni i saj të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër, në rastet e tilla, përkatësisht lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, parashtruesit e kërkesës duhet t'i paraqesin Gjykatës argumente përkatëse lidhur me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve për të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar me divergjenca në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar me shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese.
53. Për më tepër, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka vënë theksin në faktin se divergjenca në praktikë gjyqësore jodetyrimsht është në kundërshtim me KEDNJ-në, sepse qasja dinamike dhe evolutive e gjykatave në interpretimin e ligjit të aplikueshëm dhe, për më tepër, zhvillimi i praktikës

gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit të drejtësisë.

54. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se qëndron fakti se ekzistojnë dallime sa i përket *“ligjit të zbatueshëm”* mes rastit të parashtruesit të kërkesës dhe rastit të Gjykatës Supreme CML. nr. 39/2018 të 25 qershorit 2018, me të cilin është pranuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Megjithatë, identifikimi i një rasti të vetëm është i pamjaftueshëm për të vërtetuar se kemi të bëjmë me *“dallime të thella dhe afatgjata”* që do çonin Gjykatën në konkludimin se kemi të bëjmë me moskonsistencën në vendimmarrje për çështje të njëjta faktike dhe juridike, dhe në konstatimin e shkeljes së parimit të sigurisë juridike.
55. Gjykata vë në pah se në arsyetimin e Njoftimit [KMLC. nr. 91/2020] të Prokurorit të Shtetit, thuhet se: *“...kreditore dhe debitorë kanë lidhur Kontratë për pagesën e borxhit më datë 23.08.2017 dhe njëkohësisht debitorë është pajtuar edhe për programin e pagesës së borxhit, sipas të cilit pagesa ka filluar më datë 23.08.2017 dhe duhej të përfundonte më datë 29.06.2020. Debitorë sipas kësaj Kontrate dhe programit për pagesën e borxhit kishte filluar që të bëjë pagesën e borxhit deri më datën 21.12.2018 dhe pastaj kishte ndërprerë pagesën e borxhit, ndërsa kreditore më datë 24.06.2019, pra ende pa kaluar një vit nga ndërprerja e pagesës së borxhit, bazuar në nenin 3 të Kontratës së datës 23.08.2017, kishte paraqitur të përmbaruesi privat propozimin për përmbarim, andaj në rastin konkret nuk mund të aprovohet pretendimi juaj që është paraqitur parashkrimi, sepse vet debitorë më vullnetin e tij ka ndërprerë afatin e parashkrimit, duke lidhur Kontratë më kreditorin dhe duke dhënë deklaratë edhe për pranimin e programit të pagesës së borxhit”*. Një arsyetim i tillë i Prokurorit të Shtetit është në pajtueshmëri me parimin e *“hierarkisë së akteve juridike”*, sepse gjykatat përkatëse vlerësuan se parashkrimi i kërkesave ndaj parashtruesit të kërkesës rregullohet me LMD-në.
56. Andaj, Gjykata, nga shtjellimet e mësipërme, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë gjykatave të rregullta, megjithatë pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-TiszazugiTarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
57. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës bie në kategorinë e tretë (iii), pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, andaj, Gjykata, si të tillë, në baza kushtetuese e deklaroi qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshëm, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtave të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës

58. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të vendosur mirë të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime *“të*

pambështetura apo të paarsyetuara” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:

a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës(Vendim)*, nr. 4241/03, të 31 majit 2005, shih, gjithashtu, rastin *Baillard kundër Francës(Vendim)*, nr. 6032/04, të 25 shtatorit 2008);

b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë të bëjë këtë (për shembull, nëse autoritetet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga shkresat e lëndës së të burgosurit për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin: KI166/20, me parashtruesin e kërkesës: *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 42).

59. Përkitazi me këto pretendime, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 33; KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, dhe së fundmi, rastin KI125/19, parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63).
60. Prandaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me këto nene të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet qartazi e pabazuar, sepse konsideron që këto pretendime i takojnë kategorisë (iii), pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht i përmend këto dispozita të Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato.

Përfundim

61. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, janë qartazi të pabazuara, sepse të njëjtat konsiderohen si pretendime që i takojnë kategorisë së parë (i), pretendime “*të shkallës së katërt*” dhe kategorisë së tretë (iii) pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” në baza kushtetuese.

62. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa, në tërësi, duhet të deklarohet qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËRKËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

